



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 37 datë 03.09.2015

Për

**“GJOBAT PËR DËMTIME NË RRJETIN RRUGOR, RRJETIN ELEKTRIK RRUGOR,
DHE HAPËSIRAT E GJELBRA TË BASHKISË TIRANË DHE METODA E VLERËSIMIT
TË DËMIT”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/1, shkronja ‘f’, nenit 33 pika 2, nenit 32, shkronja ‘k’ të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenet 124 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); neni 15 i ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor” (i ndryshuar); neni 32, pikat 7 dhe 8 të Rregullores Nr. 22 AKEP, datë 24.06.2011 "Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike" (e ndryshuar); neni 10, pika 3 e neni 12 i ligjit 10.279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak

VENDOSI:

1. Dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin rrugor, të listuara më poshtë, dënohen me gjobë 10.000 Lekë:
 - a) Dëmtim, çarje, ndotje rruge;
 - b) Bllokim rruge në masën;
 - c) Dëmtim, çarje, ndotje trotuari;
 - d) Dëmtim bordure;
 - e) Dëmtim, bllokim pusete, kunete;
 - f) Vjedhje kapaku pusete, zgarë.
2. Dëmtimet dhe/ose e ndërhyrjet në rrjetin elektrik rrugor, rrjeti i telefonisë fikse, të listuara më poshtë, dënohen me gjobë në masën 20.000 Lekë:
 - a) Lidhjet e pa-miratuara në kandelabrat apo rrjetin ajror;
 - b) Dëmtim i shtyllave;
 - c) Dëmtim i ndriçuesve;

- d) Përdorimi i shtyllave si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllave elektrikë, telefonikë, internetit etj;
 - e) Dëmtimi i traseve kabllorë e linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje si edhe shkulja e shtyllave;
 - f) Ndërhyrjet në kuadrot e komandimit.
3. Dëmtimet dhe/ose ndërhyrjet në rrjetin e ujësjellësit, të listuara më poshtë, dënohen me gjobë në masën 20.000 Lekë:
- a) Lidhjet e pamiratuara në tubacion;
 - b) Dëmtim i pusetave;
 - c) Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje.
4. Dëmtimet dhe/ose ndërhyrjet në hapësirat e gjelbërta dënohen me gjobë 20.000 Lekë:
- a) Dëmtim hapësire të gjelbër;
 - b) Zënie hapësire të gjelbër pa leje;
 - c) Dëmtim, prerje pemësh;
 - d) Vendosje posterash pa leje;
 - e) Vendosje tabelash, pankartash, banderolash pa leje.
5. Struktura përgjegjëse për shqyrtimin e kundërvatjes dhe vendosjen e gjobës është Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, Bashkia Tiranë.
6. Nëse Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, Bashkia Tiranë, konstaton shkaktim dëmi që vjen si pasojë e kundërvajtjes, vlerëson masën e dëmit dhe me një akt administrativ më vete vendos shpërblimin e dëmit.
7. Përlllogaritja e dëmit të kryhet sipas kësaj formule: $Dm = TSDm \times KRb$
- TSDm = totali i sendeve të dëmtuara;
- KRb = kosto për kthimin në gjendjen e mëparshme të sendit të dëmtuar e cila përlllogaritet sipas Aneksit nr. 1, Aneksi nr. 2 dhe Aneksi nr.3 bashkëlidhur këtij vendimi.
- Kostot për rehabilitimin e sendeve të dëmtuara i vihen në dispozicion Agjencisë për Mbrojtjen e Konsumatorit çdo 6 muaj nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qyteti, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qyteti dhe UKT Sh.A.
8. Të ardhurat e realizuara nga gjobat dhe dëmshpërblimet shkojnë në të ardhurat e Bashkisë së Tiranës. Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tatimeve Vendore është struktura përgjegjëse për arkëtimin dhe ekzekutimin e detyrueshëm të tyre.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tatimeve Vendore, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qyteti, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qyteti dhe UKT Sh.A.

10. Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, Bashkia Tiranë, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi duhet të hartojë dhe miratojë formularin e (i) akt-konstatimit të dëmit të shkaktuar dhe (ii) aktit administrativ shoqërues që përcakton dëmshpërblimin.
11. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 6, datë 26.01.2001 për “Vendosjen e gjobave nga Bashkia Tiranë”, shfuqizohet.
12. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI

